# REPUBLIKA E SHQIPËRISË
# KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
# KORÇË

## VENDIM

**Nr. 41 Datë 10.04.09**

**Për miratimin e fondit shtesë në kuadër të festimit të 100 vjetorit të shoqërisë së parë sportive "Vllazëria" të Korçës.**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës , i mledhur në datën e sotme , pasi morri në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Klubi Shumësportësh "Skënderbeu" Korçë për kërkësën e fondit shtesë në kuadër të festimit të 100 vjetorit të shoqërisë së parë sportive "Vllazëria " të Korçës bazuarne Ligjin 8652 dt.31.07.2000, "Për organizmin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 32 pika v, ne ligjin nr.9936 dt.26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqipërisë ", në ligjin nr.10025 datë 27.11.2008 "Për buxhetin e shtetit te vitit 2009", në Udhëzimin e MF nr.2 dt.12.01.2009 "Për zbatimin e buxhetit 2009", si dhe VKB nr.12 dt.13.02.2009 "Mbi miratimin e buxhetit te Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë 2009" , mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve :

**VENDOSI**

1.Te miratoje shtesen e fondit prej 323200 leke per institucionin e klubit shumesportesh "Skenderbeu".

2.Ky fond do të përballohet nga fondi rezervë i të ardhurave të Bashkisë me këtë strukturë buxhetore.
Pakësohet 00 04980 05 Art 6090000- 323200
Shtohet 00 08140 05 Art 6020000+323200 klubi shumesportesh "Skenderbeu".

3.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Klubi Shumesportesh "Skenderbeu".

4.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari

Raimonda Nase

Dixhitalizuar nga Qendra ÇIP
www.infocip.org